



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 8/2023 regjistër (JR)
Datë 24.02.2023

Nr. 57 i vendimit
Datë 18.07.2025

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 18.07.2025, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik, Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 600, datë 19.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Robert Kote.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike të zhvilluar në datat 10.06.2025, 18.06.2025, 03.07.2025, 09.07.2025 dhe 18.07.2025, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi pretendimet e

ngritura në ankim nga Komisioneri Publik, Florian Ballhysa, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 600, datë 19.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 600, datë 19.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe pasi analizoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi mospranimin e ankimit të Komisionerit Publik dhe lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Robert Kote (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41, pika 1 të ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
 - 2.1. ILDKPKI-ja dërgoi pranë Komisionit raportin përfundimtar për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas së cilit: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
 - 2.2 DSIK-ja, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës të subjektit të rivlerësimit, ka përcjellë raportin e vlerësimit të përditësuar, në të cilin ka konfirmuar konstatimin fillestar për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e detyrës dhe duke e lënë konkluzionin në vlerësimin e Komisionit, nën dritën e informacioneve e gjetjeve të rezultuara nga hetimi administrativ.
 - 2.3 KLP-ja kreu vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit bazuar në formularin e vetëdeklarimit dhe dokumentet që shoqërojnë atë, 3 (tre) dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, 5 (pesë) dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe në të dhënat nga burimet arkivore të 23 prokurorive të rretheve gjyqësore dhe të Prokurorisë së Përgjithshme. Në përfundim të procesit të kontrollit, i dërgoi Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të kryer për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit:
- a. Ka arritur nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Nga kontrolli i pasurisë nuk u evidentuan pasuri më të mëdha në pronësi e përdorim, nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Subjekti nuk ka kryer deklaram të rremë apo të pamjaftueshëm dhe ai nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit. Situata negative financiare prej (-) 521.409 lekësh për vitin 2014 - 2015, mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, nuk duhet të përbëjë shkak për aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
 - b. Ka arritur nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, pasi ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nuk u provua që të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
 - c. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë dhe është efektiv në punën e tij e, për rrjedhojë, ka arritur nivelin kualifikues të kërkuar nga neni 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin e aftësive profesionale.
 - d. Në një vlerësim tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, veprimet e subjektit të rivlerësimit në procedimin penal nr. {****}/2016 nuk mund të kualifikohen si shkelje të rënda profesionale. Vetëm zgjidhja e çështjes, e vlerësuar në tërësinë e saj dhe në raport me aktivitetin e gjatë të subjektit të rivlerësimit në sistem, nuk mund të konsiderohet se ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Sa i përket kontaktit të subjektit të rivlerësimit me një individ [z. Y. G.], Komisioni nuk gjeti rrethana për ta konstatuar atë si një person të përfshirë në krimin e organizuar dhe as marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me të, të tillë që cenon standardin e besueshmërisë së një prokurori.

3.1. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave të çështjes, Komisioni vlerësoi se nuk duhet të aplikohet neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi vjen në disproporcion me qëllimet e procesit të rivlerësimit. Në përfundim, Komisioni vendosi¹ *konfirmimin në detyrë* të subjektit të rivlerësimit.

III. Shkaqet e ankimit të Komisioneri Publik

4. Komisioneri Publik, z. Florian Ballhysa, ushtroi ankim kundër vendimit nr. 600, datë 19.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me objekt ndryshimin e këtij vendimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Komisioneri Publik shprehet se nga shqyrtimi i vendimit

¹ Me shumicë votash.

objekt ankimi dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat e bëjnë këtë vendim të cenueshëm në tërësinë e tij. Vendimi i Komisionit përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit, pasi përfundimet e arritura nga Komisioni duket se nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit për të tria kriteret e vlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë. Në mënyrë të përmbledhur, Komisioneri Publik vlerëson se:

4.1. Në lidhje me kriterin e pasurisë, Komisioneri Publik ka ngritur pretendime si vijon:

4.1.1. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të ardhurash të ligjshme për të investuar në shumën (-) 783.737 lekë për *blerjen e autoveturës “Audi A4”, me targë {***}*. Subjekti duket se ka kryer veprim fiktiv, duke përcaktuar një çmim disa herë më të lartë në shitjen e pasurisë autoveturë me targë {***}, marka Rover, shërbyer si burim për blerjen e pasurisë autoveturë me targë {***}.

4.1.2. Lidhur me *shpenzimet e shkollimit dhe jetesës të vajzës së subjektit/zj. S. K.*, në Vjenë, Austri, Komisioneri Publik çmon se mosdeklarimi në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore, i shpenzimeve të shkollimit dhe të jetesës të vajzës së subjektit, në Vjenë, Austri, deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe mungesa e një dokumentacioni të plotë justifikues ligjor lidhur me këto shpenzime, krijojnë pamundësinë për të verifikuar se cilat ndër deklaratimet e subjektit të rivlerësimit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike, duke krijuar, për rrjedhojë pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

4.1.3. Për *autoveturën e markës “Audi A4”, me targë {***}*, blerë dhe rishitur brenda vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe kontradiktore lidhur me shumën e paguara në momentin e blerjes së kësaj pasurie dhe detyrimin e papërbushur për këtë pasuri, të cilat kanë krijuar pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie. Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur në shumën 1.055.000 lekë, deri në datën 29.06.2016 të blerjes së këtij automjeti, rezultojnë të pamjaftueshme për të mbuluar me burime të ligjshme, blerjen e këtij automjeti në vlerën 1.320.000 lekë dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, që më së paku përllogariten në vlerën 800.000 lekë.

4.1.4. Për pasurinë *ambient shërbimi me sipërfaqe 68 m²*, në rrugën “{***}”, Tiranë, Komisioneri Publik pretendon se: (a) rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ i kryer në Komision të çojnë në konkluzionin e veprimeve fiktive në dukje të subjektit të rivlerësimit në marrëdhënien e shitblerjes me kusht të kësaj pasurie, sjellje kjo me karakter përsëritës; (b) subjekti rezulton në *pamundësi financiare* për të paguar shumën 15.000 euro në muajin shkurt 2017; (c) marrëdhëniet e subjektit të rivlerësimit me z. E. L., si person i dënuar në momentin e nënshkrimit të kontratave paraprake të shitjes apo me z. Y. G., për të cilin deklaroi miqësi 25-vjeçare, janë sjellje të cilat duhen parë në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 të ligjit 84/2016, si sjellje që cenonë besimin e publikut të drejtësisë.

4.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, në vlerësim të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. {***}/2016, Komisioneri Publik pretendon se ndonëse rasti i referuar në raportin e DSIK-së, që ngre dyshime për veprime të paligjshme, në dukje nuk përmban elemente që të cilësohen me ndikim në vlerësimin e kriterit për kontrollin figurës dhe në funksion të përcaktimit të ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme, elementet e këtij procedimi penal në raport me gjetjet e tjera, duhen çmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si situata të cilat mund të ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

4.3. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, në vlerësim të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. {***}/2017, Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi ndryshimi i cilësimit të veprës penale nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjyqimit në seancën paraprake nuk duket i bërë mbi akte të reja, të ndryshme nga ato të administruara në fashikullin e procedimit penal. Ankuesi vlerëson se elementet e këtij procedimi, në raport dhe me gjetjet e tjera, duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata të cilat mund të ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Pretendimet e palëve gjatë gjyqimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

5. Përpara zhvillimit të seancës gjyqësore publike të datës 10.06.2025, në Kolegji, u depozituan parashtrime dhe akte përkatësisht nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme² dhe nga subjekti i rivlerësimit³. Aktet e depozituara në Kolegji iu njoftuan respektivisht Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, subjektit të rivlerësimit dhe Vëzhguesit Ndërkombëtar.

5.1. Në parashtrimet e paraqitura në Kolegji, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, iu qëndroi të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e datës 14.02.2023 të Komisionerit Publik (përmbledhur në paragrafët më sipër). Me pretendimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë, u kërkua ndryshimi i vendimit objekt ankimi dhe shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit.

5.2. Në parashtrimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar shkaqet ankimore, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur si vijon.

5.2.1. Subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e autoveturës tip “Audi A4”, me targë {***}. Çmimi i shitjes së automjetit tjetër të markës “Rover” ka qenë okazion për shkaqe që lidheshin me cilësitë teknike të automjetit dhe nuk duhet konsideruar si veprim fiktiv. Të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti duhen konsideruar si burim i ligjshëm për blerjen e automjetit objekt kontrolli. Në deklaratën periodike të vitit 2014, ka deklaruar se burimi i krjimit për blerjen e automjetit Audi A4, kanë qenë të ardhurat nga shitja e automjetit Rover në vlerën

² Nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 05.06.2025, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, depozitoi parashtrime me shkrim dhe autorizimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. {***} prot., datë 05.06.2025, për përfaqësimin e çështjes në seancë publike nga prokurori Klodjan Braho.

³ Në datën 03.06.2025 subjekti i rivlerësimit depozitoi parashtrime me kërkimin për administrimin e provave të reja: (i) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.06.2025 për komunikimin elektronik ndërmjet vajzës së subjektit dhe Universitetit të Vienës; (ii) vendim penal nr. {***}, datë 02.11.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; (iii) vërtetim bankar datë 02.06.2025 i Bankës Amerikane të Investimeve.

4.000 euro dhe kursimet, duke shëruar kështu pasaktësitë në deklaratimet e mëparshme për gjendjen e cash-it nga vitet paraardhëse.

5.2.2. Sa i përket shpenzimeve të shkollimit, subjekti nuk ka pasur detyrim për deklaram, pasi shuma e shpenzimeve të shkollimit në një vit deklarami ka qenë nën kufirin e deklarueshëm prej 300.000 lekësh. Subjekti ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor se vajza e tij nuk i ka filluar ndonjëherë studimet e larta në Vjenë, Austri, ndërsa shpenzimet e kursit të gjuhës së huaj, që zgjati më pak se gjashtë muaj, kanë qenë në masën 2.500 euro. Sa i përket shpenzimeve të jetesës, subjekti nuk ka pasur detyrimin për deklarimin e tyre, për shkak se ato përbëjnë shpenzime të vazhdueshme gjatë vitit të deklarimit dhe, si të tilla, nuk janë të detyrueshme për t'u deklaruar në kuptim të ligjit. Parashikimi në germën "h" të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, që përcakton si detyrim deklarimin e çdo shpenzimi me vlerë mbi 300.000 lekë, i referohet një shpenzimi konkret të kryer njëherësh që tejkalon vlerën 300.000 lekë dhe jo shpenzimit të përmuajshëm dhe vazhdues. Në rast se shpenzimi i përmuajshëm do të ishte i detyrueshëm për deklaram, përfshirë dhe shpenzimet e jetesës së vajzës në Vjenë, Austri, atëherë Komisioneri Publik do të duhej të kërkonte dhe detyrimin për deklarimin e shpenzimeve të jetesës në Shqipëri, për sa kohë këto shpenzime familjare janë mbi vlerën 300.000 lekë. Edhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit, nuk është kërkuar për subjektet e rivlerësimit detyrimi për deklarimin e shpenzimeve të jetesës. Komisioneri Publik e ngre mosdeklarimin e shpenzimeve të jetesës së vajzës, vetëm për të përligjur qëllimin e tij, për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit të dhënë ndaj subjektit.

5.2.3. Automjeti tip "Audi A4", me targë {***}, blerë shoqërisë "{***}" ShPK, me përfaqësues ligjor z. E. J. kundrejt çmimit 1.980.000 lekë, iu shit brenda vitit të njëjtit individ [E. J.], për shkak të mospërmbushjes nga ana e subjektit e pagesës së çmimit të blerjes. Vlera 980.000 lekë e shënuar në kontratën e shitjes kësaj shoqërie ishte vlera e palikuiduar nga ana e subjektit dhe përfaqësonte pikërisht diferencën ndërmjet çmimit të blerjes prej 1.980.000 lekësh me vlerën 340.000 lekë të likuiduar nga subjekti. Si burim krijimi për pagesën e shumës 340.000 lekë, kanë shërbyer të ardhurat nga paga e tij, pensioni dhe të ardhurat e bashkëshortes, si dhe tërheqja e diferencës së kredisë në shumën 120.000 lekë (500.000 - 380.000 lekë).

5.2.4. Për ambientin e shërbimit me sipërfaqe 68 m², ndodhur në Tiranë, subjekti pretendon se në datën 20.02.2017 ka lidhur një kontratë paraprake shitje me shoqërinë "{***}" ShPK, në bazë të së cilës është lidhur kontrata e kredisë me ABI Bank dhe disbursuar kredia tregtare me vlerë 30.000 euro, e cila vijon të shlyhet nga ana e subjektit. Kontrata paraprake e shitblerjes e lidhur ndërmjet subjektit dhe shoqërisë është revokuar dhe kjo pasuri i është shitur nga shoqëria një tjetër individ. Duke qenë jashtë periudhës së rivlerësimit, kontrata e porosisë e datës 20.02.2017 është bërë objekt kontrolli administrativ nga ana e ILDKPKI-së, e cila e ka sanksionuar subjektin me gjobë, dhe në vijim, mbi ankimin e subjektit është bërë edhe objekt kontrolli gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila e ka shfuqizuar vendimin e mësipërm të ILDKPKI-së.

5.2.5. Analiza e përgjithshme financiare rezultoi me një balancë negative modeste prej (-) 521.409 lekësh për periudhën 2014 - 2015, e cila nuk legjitimon aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësuar nën dritën e parimit të proporcionalitetit.

5.2.6. Subjekti ka kundërshtuar konkluzionet e ankuesve në lidhje me *procedimin penal nr. {***}/2016* të kontrolluar në kuadër të kontrollit të figurës. Subjekti i rivlerësimit potencon se në momentin e regjistrimit të këtij procedimi penal ka çmuar se vepra penale duhej të kualifikohej sipas nenit 278/2 të Kodit penal dhe jo sipas nenit 278/5, pasi nga hetimi penal nuk u provua se transportimi i municioneve ishte kryer me qëllim tregtimi. Në momentin e regjistrimit të kësaj çështje penale, neni 278 sapo ishte riformuluar dhe nuk ka pasur një praktikë të konsoliduar për veprimin e kundërligjshëm të transportimit të municioneve. Para ndryshimeve ligjore të vitit 2016, në nenin 278 të Kodit Penal, nuk parashikohej si formë e veçantë e anës objektive transportimi i municioneve, por vetëm prodhimi dhe mbajtja e tyre. Kualifikimi i veprës penale është kryer bazuar në bindjen e tij të brendshme dhe pa u ndikuar nga rrethana të tjera njëanshmërie.

5.2.7. *Së fundmi*, lidhur me denoncimin e një individi (A. D.) për *procedimin penal nr. {***}/2017*, që u bë pjesë e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti prapëson se faktet e denoncuar janë tërësisht të gabuara, pasi: (i) veprimtaria e prokurorit përpara dërgimit të çështjes në gjykim kontrollohet nga gjyqtari i seancës paraprake, i cili e ka gjetur të drejtë ndryshimin e akuzës së prokurorit; (ii) trupi gjykues që shqyrtoi themelin e çështjes e ka gjetur të drejtë cilësimin juridik të saktësuar nga prokurori/subjekti në seancën paraprake; (iii) gjykimi i themelit të çështjes ka përfunduar edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila me vendimin e datës 18.07.2024, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

V. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja me objekt shqyrtimi kundërshtimin e vendimit të Komisionit bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit, me përbërjen si në pjesën hyrëse të këtij vendimi, është rezultat i shortit të zhvilluar në datën 01.03.2023, i cili është publikuar në faqen zyrtare të Kolegjit.

ii) Legjitimimi i ankuesit

7. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit*

8. Shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 600, datë 19.12.2022, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike, në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

9. Në seancën gjyqësore të datës 10.06.2025, për shkak të mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë dhe bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe të nenit 199, paragrafi i 2-të i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues i Kolegjit deklaroi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ky i fundit, në bazë të autorizimit të datës 05.06.2025, u përfaqësua nga prokurori Klodjan Braho.

9.1. Në këtë seancë gjyqësore, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e tij deklaroi në linjë me ankimin e Komisionerit Publik, sikurse referuar më sipër për: (i) pasurinë autoveturë, e markës “Audi A4”, me targa {***} dhe për automjetin e markës “Rover” shërbyer si burim krijimi për të; (ii) shpenzimet e shkollimit dhe të jetesës, për personin e lidhur/vajzën e subjektit; (iii) autoveturën, tip “Audi A4”, me targa {***}, blerë dhe rishitur brenda vitit 2016; (iv) për ambientin e shërbimit me sipërfaqe 68 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë; (v) për procedimin penal nr. {***}, viti 2016, në ngarkim të K. T. dhe A. S.; si dhe (vi) për denoncimin e z. A. D., lidhur me procedimin penal nr. {***}/2017. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vlerëson në këto parashtrime se referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret ndan qëndrim të kundërt me shumicën e trupës gjykuese të Komisionit dhe vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kërkoi ndryshimin e vendimit objekt ankimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

9.2. Subjekti i rivlerësimit gjatë prezantimit të parashtrimeve të tij pretendoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit, sikurse referuar më sipër, dhe në mbështetje të pretendimeve depozitoi disa akte të reja⁴, të cilat kërkoi të pranohen si provë nga trupi gjykues. Ai parashtrioi se shkaqet e ankimit janë të pabazuara në ligj e në prova, të paargumentuara, joracionale dhe në mospërputhje me dispozitat e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

9.3. Bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës, aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues nuk e mbylli hetimin gjyqësor në këtë seancë, duke i lënë mundësi subjektit të depozitojë në seancën e radhës, vendimin nr. {***} akti, datë 18.07.2024, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të cituar në paragrafin 47/1 të parashtrimeve të subjektit, i cili rezultoi se nuk i ishte bashkëlidhur parashtrimeve. Në përfundim të kësaj seance, palët u ftuan të dorëzojnë konkluzionet përfundimtare në seancën e radhës.

10. Në seancën e datës 18.06.2025, palët u informuan se subjekti i rivlerësimit kishte paraqitur në Kolegj, vendimin e shkurtuar të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, i cili i ishte përcjellë edhe përfaqësuesit të Prokurorisë së Posaçme, për qëllime vlerësimi në konkluzionet

⁴ Listuar më lart, në poshtëshënimin nr. 3 të këtij vendimi të Kolegjit.

përfundimtare. Pasi palët deklaruan se nuk kishin kërkesa të tjera procedurale, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit gjyqësor dhe i ftoi ato në paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare.

10.1. Në bisedimet e tij përfundimtare, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ndryshe nga sa ishte parashtruar në ankimin e Komisionerit Publik dhe në parashtrimet në seancën gjyqësore publike të datës 10.06.2025, kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi që konfirmoi subjektin në detyrën e prokurorit. Arsyetimi mbi të cilin e ka bazuar këtë kërkim parashtrohet si vijon.

10.1.1. Lidhur me automjetin e markës “Audi A4”, me targë {***}, blerë në vitin 2014, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë financiare në vlerën (-) 783.737 lekë për krijimin e kësaj pasurie. Edhe nëse do të përfshihej në mesin e burimeve të ligjshme shuma 4.000 euro nga shitja e automjetit tip “Rover”, përsëri do të rezultonte mungesë burimesh për blerjen e automjetit objekt kontrolli, që në këtë rast do të llogaritej në rreth (-) 400.000 lekë.

10.1.2. Lidhur me shpenzimet e shkollimit dhe të jetesës së vajzës së subjektit në Vjenë, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vlerëson se komunikimi elektronik i depozituar nga subjekti me parashtrimet në Kolegj, konfirmon se vajza e tij nuk është kualifikuar për të filluar programin arsimor Bachelor në Universitetin e Vjenës. Referuar këtij akti të ri dhe në kushtet që nuk rezultoi ndonjë rrethanë e re që të provojë shpenzime të tjera të kryera nga vajza e subjektit, përveç atyre të përfshira në analizën përfundimtare të Komisionit, balanca negative prej (-) 133.127 lekësh për vitin 2015 e konstatuar në Komision, duhet marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të pasurisë.

10.1.3. Për pasurinë autoveturë tip “Audi A4”, me targa {***}, blerë dhe rishitur brenda vitit 2016, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme e ka vlerësuar të arsyeshëm shpjegimin e dhënë nga subjekti në parashtrimet e depozituara në Kolegj se shuma e paguar prej tij për automjetin ka qenë 340.000 lekë. Ankuesi vlerësoi përfundimisht për këtë pasuri se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, deri në datën kur është blerë ky automjet, së bashku me pjesën e mbetur nga kredia e disbursuar në mars 2016, janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve dhe për pagesën e automjetit në vlerën 340.000 lekë.

10.1.4. Lidhur me shkakun e ankimit për njësinë e shërbimit me sipërfaqe 68 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimit se ai ka kryer veprime në dukje fiktive me qëllim përfitimin e kredisë prej 30.000 eurosh pranë ABI Bank dhe jo blerjen e kësaj pasurie. Sa i përket rrethanave të konstatuara lidhur me kredinë e marrë pranë ABI Bank dhe marrëdhënies së subjektit me individët E. L. dhe Y. G., përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vlerëson se nuk e ngarkojnë subjektin me ndonjë sjellje që duhet parë në vlerësimin tërësor, që cenon besimin e publikut te drejtësia, në një masë të tillë që do të justifikonte shkarkimin e tij nga detyra. Nuk vërtetohet dijenia e subjektit për dënimin e individit të parë, ndërsa procedimet penale për individin tjetër janë regjistruar pas lindjes së marrëdhënies kontraktuale të garancisë së kredisë.

10.1.5. Në konkluzion të kriterit të pasurisë, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vlerësoi se pamjaftueshmëria financiare në shumën (-) 783.737 lekë e konstatuar për pasurinë autoveturë, me targë {***}, blerë në vitin 2014 dhe pamjaftueshmëria në shumën (-) 133.127 lekë e konstatuar lidhur me shpenzimet e jetesës së vajzës së subjektit në Vjenë, në vlerësim të situatës të çështjes objekt vlerësimi, nuk e cenon besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe nuk e kalon masën e proporcionalitetit të zbatuar deri tani nga Kolegji në raste të ngjashme.

10.1.6. Në lidhje me procedimin penal nr. {***}, viti 2016, në ngarkim të dy individëve [K. T. dhe A. S.], përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vlerësoi përfundimisht, se ndonëse kërkimi i shprehur në ankim është i bazuar, mangësitë e konstatuara vetëm për këtë procedim penal janë të tilla që nuk justifikojnë zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

10.1.7. Sa i përket denoncimit në lidhje me procedimin penal nr. {***}/2017, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit dhe shkurtimit të vendimit, datë 18.07.2024, të Gjykatën së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të depozituar si provë në Kolegj, e vlerësoi të shëruar shkakun ankimor në lidhje me këtë procedim penal.

10.1.8. Në konkluzion të sa më sipër, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Klodian Braho, kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 600, datë 19.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

10.2. Në bisedimet e tij përfundimtare, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, pasi nuk ka asnjë provë që shkaqet e pretenduara nga Komisioneri Publik, që lidhen me vlerësimin tërësor, të kenë lidhje me ndonjë element të fshehjes së burimit të të ardhurave, të cenimit të figurës apo profesionalizmit. Subjekti kërkon mospranimin e ankimit të Komisionerit Publik dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, objekt ankimi.

10.3. Pasi dëgjoi konkluzionet përfundimtare të palëve, trupi gjykues i Kolegjit deklaroi të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe u tërhoq në dhomë këshillimi për të marrë vendimin përfundimtar lidhur me çështjen, të cilin do ta shpallte në datën 03.07.2025.

- 11.** Në seancën publike të datës 03.07.2025, palët prezente⁵ u bënë me dije se gjatë bisedimeve në dhomë këshillimi dhe në funksion të tyre, trupi gjykues u ndal për të analizuar kërkimin përfundimtar të ankuesit, përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe çmoi me rëndësi qartësimin nëpërmjet pyetjeve që do të duhet t'i bëheshin atij në këndvështrimin procedural lidhur me kërkimin përfundimtar të përcjellë në Kolegj. Për këtë arsye, në bisedimet e zhvilluara në dhomë këshillimi në datën 01.07.2025, trupi gjykues revokoi vendimin e ndërmjetëm të marrë në seancën e datës 18 qershor 2025, për mbylljen e shqyrtimit gjyqësor dhe tërheqjen në dhomë këshillimi për marrjen e vendimit lidhur me çështjen. Në kushtet kur çmoi se qartësimi për sa më sipër do të duhet të bëhej nëpërmjet pyetjeve, për shkak të mungesës në këtë seancë të përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe pamundësisë për të kryer këtë veprim procedural, trupi gjykues vendosi që seanca të shtyhej për në datën 09.07.2025.

⁵ Në këtë seancë u konstatua mosprezenca e përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

12. Në seancën publike të datës 09.07.2025, në vijim të pyetjes konkrete të trupit gjykues, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deklaroi se kërkimi i tyre nuk është heqja dorë nga gjykimi, por që shkaqet e ankimit të merren në shqyrtim, prapësimet dhe provat e administruara gjatë procesit të merren në konsideratë dhe të gjykohen, në mënyrë që të mos pamundësohet kontrolli i vendimit të Komisionit nga Kolegji. Përfundimisht, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kërkoi konfirmimin, lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 600, datë 19.12.2022, duke e vlerësuar një zgjidhje të drejtë të çështjes.

B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

13. Pasi analizoi konkluzionet përfundimtare të palëve, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit vlerësoi se kërkimi përfundimtar i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, nëse analizohet në harmoni e ndërthurur me gjithë ngjarjet procedurale në këtë çështje, duhet të konsiderohet se ka barazuar efektet me ato të heqjes dorë nga ankimi. Aspektet dhe analiza mbi të cilin u arrit në këtë konkluzion shtjellohet në vijim.

13.1. *Së pari*, në ankimin e tij, Komisioneri Publik kërkoi ndryshimin e vendimit dhe shkarkimin e subjektit, pasi vendimi i Komisionit ishte i cenueshëm në tërësinë e tij. Shkaqet e ankimit përfshinin kriterin e pasurisë dhe atë të vlerësimit profesional e gjetjes në raportin e DSIK-së. Ky qëndrim u konfirmua edhe në parashtrimet në Kolegji, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Në bisedimet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kërkoi lënien në fuqi të vendimit, ndonëse kjo alternativë nuk ekzistonte në ankim.

13.2. *Së dyti*, dhe si rrjedhojë e sa më sipër, kërkimi përfundimtar për lënien në fuqi të vendimit objekt ankimi u analizua në ndërthurjen mes interesit të ligjshëm për vijuar procesin përpara gjykatës dhe të drejtës për akses në gjykatë, sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Pikërisht nën këtë dritë, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje pikësëpari që kjo e drejtë nënkupton edhe që mjetet e përdorura për aksesin në gjykatë, të jenë në proporcion e përputhje me qëllimin e ndjekur⁶. Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se nënshtrimi i ankimit analizës kontrolluese të Kolegjit njëkohësisht me kërkesën për konfirmimin e subjektit në detyrë, mund të arsyetohet vetëm si një situatë në të cilën ankuesi nuk ruan/posedon më, një interes të ligjshëm për të kontestuar një vendim, pasi në thelb, ushtrimi procedural është tërësisht teorik, e i pamundur të ndryshojë vendimin objekt ankimi. E thënë në të kundërt, mungesa e një interesi të ligjshëm nënkupton që Kolegji do të përfshihej në çështje e do t'i përgjigjej pyetjeve tërësisht *hipotetike*, zgjidhja e të cilave nuk ka mundësi të sjellë pasojë ligjore⁷.

13.3. *Së treti*, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në rrethanat që deduktohet mungesë e interesit të ligjshëm, një vendimarrje e Kolegjit, e ndryshme nga ajo e kërkuar nga ankuesi, teorikisht do ta

⁶ *Shih ndër të tjerë, Ashingdane k. Mbretërisë së Bashkuar, Bellet kundër Francës, Golder k. Mbretërisë së Bashkuar, në hudoc.echr.coe.int.*

⁷ *Gjykata Europiane e Drejtësisë, në çështjen T-19/06, Mindo Srl v Komisionit Evropian, paragrafi 90, në <https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?jsessionid=0F113F2007668B7AB5B0384B1B9B572B?text=&docid=110401&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=6563354>.*

bënte vendimin të cenueshëm, nëse do të ankimohej nga subjekti i rivlerësimit. Në këtë vlerësim, është e nevojshme të theksohet që jurisprudenca e Kolegjit, gjatë funksionit të tij tetë (8) vjeçar, ka konsoliduar qëndrime standarde për zgjidhjen e problematikave, të cilat në çështjen konkrete mund të diktonin një zgjidhje të ndryshme nga ajo e kërkuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, edhe pasi gjatë shqyrtimit gjyqësor, aktet e sjella *a prima facie* fokusoheshin në drejtim të çështjeve faktike, që nuk përbënin shkak ankimi apo fakte pa relevancë në çfarë sillej për analizë nëpërmjet ankimit.

13.4. *Së fundmi*, ndonëse ankimi nuk përmbante kërkim alternativ, ndryshimi tërësisht i kërimit, i cili drejtoi Kolegjin drejt zgjidhjes për lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, passjell automatikisht si rezultat logjik, mosshqyrtimin e fakteve juridike të natyrës materiale dhe mënyrës së zbatimit të ligjit material lidhur me to. Ky qëndrim ka në thelb argumentin që, ndonëse Komisioneri Publik, në ankim, por edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në parashtrimet në Kolegj, nuk i kishte paraqitur Kolegjit kërkesë për hetim dhe një kërkim alternativ [ndryshim ose lënie në fuqi të vendimit të Komisionit pas kryerjes së veprimeve hetimore të caktuara], duke qenë se e konsideronte të hetuar në mënyrë të plotë situatën faktike në Komision, në bisedimet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka ndryshuar kërkimin e ankimit, duke mbështetur konkluzionet e Komisionit për çdo shkak ankimi e duke u vendosur për rrjedhojë në momentin procedural në të cilin vlerëson ushtrimin e të drejtës së ankimit. Ky ndryshim i kërimit të ankuesit, në vijim të analizës e faktorëve të mësipërm, dhe nën dritën e garancive procedurale që duhet të udhëheqin procesin, u arsyetua se e vendos Kolegjin, në këto rrethana, në kushtet e pranimit të vendimit të Komisionit, në gjendjen që është dhe pa ia nënshtruar atë një vlerësimi të mëtejshëm.

13.5. Për sa më sipër, në premisën që kërkitimi përfundimtar për lënien në fuqi të vendimit, mund të barazohet nga pasojat me heqjen dorë nga ankimi nga titullari i përcaktuar për këtë qëllim, sipas parimeve procedurale civile, të cilat normojnë edhe procesin e rivlerësimit në zbatim të pikës 6,⁸ të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 2⁹ të nenit 1 të ligjit nr. 49/2012, duke mos pasur më lëndë të shqyrtojë çështjen për të cilën është vënë në lëvizje dhe, në linjë me vendime të mëparshme të tij, Kolegji vëren se kjo vendimmarrje passjell që vendimi objekt ankimi i Komisionit, nëpërmjet të cilit është konfirmuar në detyrë subjekti i rivlerësimit, merr formë të prerë, sikurse përcakton neni 451, germa “b” e Kodit të Procedurës Civile, në momentin e shpalljes së këtij vendimi.

14. Në funksion të qartësisht të pozitës procedurale të subjektit të rivlerësimit, në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit nr. 84/2016, konsideruar natyrën e posaçme të këtij procesi, Kolegji gjen me vend të deklarojë, për efekt të këtij procesi, edhe efektin ligjor që prodhon kjo vendimmarrje në raport me vendimin e Komisionit. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji konstaton

⁸ “[6.] Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.”

⁹ “[2.] Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për atë sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.”

se në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nenet 1, pika 2 dhe 44 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe nenet 451, germa “b” dhe 463 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi nr. 600, datë 19.12.2022, ndaj të cilit është ushtruar ankimi, do të konsiderohet se merr formë të prerë në momentin që Kolegji merr vendimin për pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 451, shkronja “b” e 463 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 8/2023, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 600, datë 19.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 18.07.2025.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi